KOLEGJI UNIVERSUM
PRISHTINË
Nr. 4256 dt. 21.04.20 21

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Mitrovicës • Opština Mitrovica • Municipality of Mitrovica
QKMF • GCPM • MFHC
Nr. 227
Date Datum Date. 19 04 2021
Vendi Mesto Place MITROVICË
Nënshkrimi Potpis Signature

KOLEGJI UNIVERSUM

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

në mes të

Kolegjit UNIVERSUM

dhe

QKMF – Komuna Mitorvicë e Jugut

I. Qëllimi i Memorandumit

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike, dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas.

II. Fushëveprimtaria

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit, QKMF – Komuna Mitorvicë e Jugut do t'u mundësoj studentëve të Programit të Infermierisë së Kolegjit Universum përfundimin e punës praktike, me kohëzgjatje të dakorduar në mes të palëve.
2. Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, Kolegji Universum do t'u mundësoj studentëve ndjekjen me rregull të orarit të praktikës, të përcaktuar nga QKMF – Komuna Mitorvicë e Jugut.
3. Rekomandimi i kandidatëve për punë praktike do të bëhet nga Kolegji Universum, përmes një komunikimi të rregullt dhe transaparent me menaxhmentin e QKMF – Komuna Mitorvicë e Jugut.

4. Kolegji Universum do të siguroj që kandidatët e përzgjedhur të jenë të nivelit të kënaqshëm dhe të kenë potencial për avancim në karrierën e tyre akademike dhe profesionale.

Scanned with CamScanner

III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuara sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuar me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjërës palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;

2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjelltë me besueshmëri të plotë;

3. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.

4. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga ana e palëve të përfshira në memorandum.

Prishtine, më: 19.04.2021

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji UNIVERSUM

Aleitin Berisha, Drejtor Ekzekutiv

Drejtori - QKMF
Komuna Mitrovicë e Jugut

Nevzat Sylejmani

Mbikqyrëse – Kryeinfermiere

Rukije Pllana

Scanned with CamScanner